

L I G J
Nr. 8562, datë 22.12.1999

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE STRUKTURËS SË FORMULËS SË
PRIVATIZIMIT TË SHOQËRISË ANONIME "ALBKROM"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Shoqëria anonime "Albkrom" i nënshtrohet privatizimit.

Neni 2

Forma e privatizimit të shoqërisë anonime "Albkrom" të jetë ajo e transferimit të së drejtës së pronësisë të aksioneve të saj të tretëve, nëpërmjet formave të parashikuara në këtë ligj ose nëpërmjet transferimit të të drejtave të përdorimit dhe zhvillimit të pasurive të shoqërisë me anë të kontratës së koncesionit, sipas formave të parashikuara në ligjin nr. 7973, datë 26.7.1995.

Neni 3

Formula e privatizimit të aksioneve të kapitalit të shoqërisë anonime "Albkrom", në rastin e transferimit të së drejtës së pronësisë të aksioneve, të jetë si vijon:

1. Jo më pak se 80 për qind e aksioneve të kapitalit i afrohet për transferim nëpërmjet shitjes investitorëve strategjikë.

Shuma e aksioneve të kapitalit, e përcaktuar në paragrafin e mësipërm, të transferohet nëpërmjet shitjes me tender të hapur ndërkombëtar.

2. Jo më shumë se 20 për qind e aksioneve të kapitalit u afrohet subjekteve të mëposhtme:

* Ish-pronarëve të truallit, sipas vlerës së përfshirë në kapitalin e shoqërisë, siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 312, datë 30.6.1994 dhe në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

* Punonjësve të "Albkrom" sh.a., me anë të shkëmbimit të aksioneve, me bonot e privatizimit që u janë dhënë atyre nga shteti.

Në kuptim të këtij paragrafi:

"Punonjës të "Albkrom"-it sh.a. konsiderohen punonjësit aktualë, ata që kanë asistencë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe punonjësit e tjerë që kanë qenë punonjës të "Albkrom"-it dhe nuk kanë përfituar nga procesi i privatizimit.

Neni 4

Përcaktimi i formës së privatizimit të "Albkrom"-it sh.a. për transferim të të drejtës së pronësisë nëpërmjet shitjes apo të drejtës së zhvillimit nëpërmjet koncesionit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Kur privatizimi i "Albkrom"-it sh.a. bëhet me anë të transferimit të së drejtës të përdorimit dhe shfrytëzimit të aseteve të shoqërisë me anë të marrëveshjes së koncesionit, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbime dhe infrastrukturë", me ndryshimet përkatëse.

Neni 6

Të ardhurat që do të përfitohen nga privatizimi i shoqërisë anonime "Albkrom", në të dy format e tij të parashikuara në nenin 2 të këtij ligji, ndahen si vijon:

1. Punonjësve të shoqërisë anonime "Albkrom", që do të dalin të papunë gjatë procesit të privatizimit, t'u jepet një shpërblim i barabartë me pagën e dy viteve.

2. Deri në 10 për qind të këtyre të ardhurave të përdoren nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit për shpenzimet e organizimit të tenderit dhe veprimtari të tjera që lidhen me të.

3. "Tarifa e suksesit", që i paguhet shoqërisë së huaj konsulente nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, zbritet nga shuma e të ardhurave nga privatizimi.

4. Pjesa tjetër e të ardhurave të derdhet në buxhetin e shtetit.

Neni 7

Mënyrat e përdorimit të të ardhurave, që do të përfitohen nga privatizimi i shoqërisë anonime "Albkrom", përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 8

Ngarkohet Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit që, me asistencën e shoqërisë së huaj konsulente në zbatim të këtij ligji, të hartojë dhe të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave aktet nënligjore përkatëse, si dhe të ndjekë dhe të organizojë kryerjen e procedurave të privatizimit për transferimin e së drejtës së pronësisë të aksioneve nëpërmjet formave të parashikuara në këtë ligj apo të privatizimit nëpërmjet procedurave dhe marrëveshjeve të koncesionit.

Neni 9

Ligji nr.8026, datë 9.11.1995 "Për privatizimin e shoqërive tregtare që veprojnë në sektorin minerar" shfuqizohet.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2526, datë 17.1.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani